



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.743/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Vehbi Rexhepi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, paraqitur kundër Husman Balxhit - Kryetar i subjektit politik Vakati, Avni Nebiu - Drejtor i Administratës në Komunën e Dragashit, Astrit Baxhaku - Zyrtar i gjendjes civile në Komunën e Dragashit, Damir Maznikar - zyrtar i gjendjes civile në Komunën e Dragashit, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Vehbi Rexhepit, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, paraqitur kundër Husman Balxhit - Kryetar i subjektit politik Vakati, Avni Nebiu - Drejtor i Administratës në Komunën e Dragashit, Astrit Baxhaku - Zyrtar i gjendjes civile në Komunën e Dragashit, Damir Maznikar - zyrtar i gjendjes civile në Komunën e Dragashit, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Vehbi Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se Husman Balxhi, kryetar i subjektit politik Vakati dhe Z. Minister Iyzhe në bashkëpunim me Avni Nebiun Drejtor i Administratës dhe sekretar i Partisë Demokratike në Dragash, Astrit Baxhakun, zyrtar i gjendjes civile dhe Damir Mazniku, zyrtar i gjendjes civile, kanë keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare duke pregaditur të gjitha dokumentet për votim me post të qytetarëve të cilët përkohësisht jetonin në Republikën e Maqedonisë, Serbisë, Turqisë etj. Më tej parashtruesi i ankesës ka shtuar se dyshon se kryesit e supozuar kanë votuar për 301 qytetar pa i konsultuar qytetarët të cilët kanë të cilët kanë qenë të përfshirë në listat e votimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në PZAP nga parashtruesi i ankesës me datë 09.11.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.743/2017 të datës 09.11.2017, ndërlidhen me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 09.11.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.743/2017 me datë 11.11.2017

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa .

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

